



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 10.07.2013

Për: **Valdete Daka**, Kryetare e Komisionit Qendror Zgjedhor

Lënda: Shkresë Shpjeguese

E nderuara Daka,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka identifikuar nevojën e hartimit të një shkresë shpjeguese për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me emërtimin e komunave bazuar në Ligjin Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrative të Komunave.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bazuar në mandatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Shtojcën XII të Rregullores 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të legjislacionit në fuqi që mbulon këtë fushë, konstaton se:

- Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrative të Komunave neni 5.4. ka përcaktuar se, në Komunën e tanishme të Mitrovicës do të themelohen dy komuna, komuna e Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut.
- Në nenin 5.5 të këtij ligji është përcaktuar renditja e komunave, përfshirë Komunën e Mitrovicës së Veriut, me Nr. rendor 30, si dhe Komunën e Mitrovicës së Jugut me Nr. rendor 31, duke përcaktuar edhe selitë e tyre.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e obligimeve ligjore që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt
Besnik Osmani,
Sekretari i Përgjithshëm në MAPL

Kopje: Slobodan Petrović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL
Arkivot të MAPL-së